REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-SKUPŠTINA OPŠTINE MALIŠEVO



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 07.04.2026
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 02/104

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

---

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/___
Datë: 30.03.2026

Mbështetur në nenin 4,5 shkronja ( b ) nenin 12 paragrafi 2 pika ( d) nenin 14 paragrafi 1, nenin 16 dhe 17 pika (c dhe h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008),Ligjin nr.08/L-237, për Kadastër të pronës së paluajtshme, neni 2 kapitulli 2, neni 13, 19, 20 neni 21 par.1 Udhëzimi Administrativ MMPHI nr.05/2023, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPH nr.12/19, për ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës neni 2 par 2.2 pika 1.4 neni 6 par 1.2, Udhëzimit Administrativ nr.09/19, Për Ndarjen e Zonave Kadastrale, Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 të datës: 14.09.2023, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.03.2026, duke vepruar sipas kërkesës së kryetarit të komunës nr.01/540, dt.18.03.2026 si dhe shkresës së MAPL-së, nr.020-326-19, dt.07.07.2025

# VENDIM
## PËR NDARJEN E PARCELLËS PUBLIKE

1. Miratohet, kërkesa e kryetarit të komunës nr.01/540, dt. 18.03.2026, për ndarjen e sipërfaqes prej 8/ha, nga sipërfaqja e tërësishme prej 166118 $m^2$ , e cila gjendet në njësinë kadastrale P-72316001-02053-0, në vendin e quajtur Gajrak-Rruga, me kulturë tokë pyjore mal i klasit 6, në pronësi të KK-Malishevës.

2. Sipërfaqja prej 4/ha, pas ndarjes, ka për qëllim të përkufizimit të sipërfaqes së ***Deponisë së Mbeturinave Inerte për Komunën e Malishevës***, lokacion i caktuar me Vendimin e Kuvendit nr.02/219, dt.05.05.2022, ndërsa nga e njëjta parcelë ndahet edhe sipërfaqja prej 4/ha, dhe secila njësi kadastrale duhet të merr numrin e ri të njësisë kadastrale, pa e ndryshuar pjesën tjetër të përshkruar në certifikatën e pronësisë bazë.

3. Me këtë vendim me rastin e ndarjes së njësisë kadastrale P-72316001-02053-0, do të krijohen tri njësi të reja me numra përkatës, pa e ndryshuar pronësinë si dhe tiparet tjera të përshkruar sipas përshkrimit të njësisë bazë.

4. Pas plotësimit të kritereve ligjore të dy ngastrat e reja, ndaras do të procedohen në Kuvendin e Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vite, konform dispozitave ligjore të Ligjit nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 6 par.6.1 pika 1.1 lidhur me nenin 8 par 1 pika 1.1.

5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen, kryetari i komunës, përmes drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe drejtorisë për pronë.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr03/040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 9 të Ligjit nr.08/L-284, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, dhe Rregullores (QRK) nr.06/2026, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores ( QRK ) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, dhe 7 ditë pas shpalljes ne ueb-faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Ademaj

Vendimi ju dërgohet
1. MAPL-së ,
2. Zyrës së Kryetarit,
3. Arkivit të komunës.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-SKUPŠTINA OPŠTINE MALIŠEVO

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 18/03/2026.
PRIMLJENO:
Nr. 01/540.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
KOMUNA E MALISHEVËS

---

Kryetari i Komunës
Nr. 01/____
Datë: 16.03.2026

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati.

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës.
Kryesuesit z.Fatmir Ademaj.

Datë: 16.03.2026.

Kopje: Arkivit të Komunës.

Lënda: Kërkesë për shqyrtim dhe miratim të ndarjes së sipërfaqes prej 4/ha, nga sipërfaqja e tërësishme prej 166118 $m^2$ për përkufizimin e lokacionit të Deponisë për Mbeturina Inerte, të përcaktuar sipas Vendimit të Kuvendit nr.02/219, dt.05.05.2022, si dhe 4/ha për qëllime të zhvillimit të aktiviteteve afariste, nga njësia kadastrale P-72316001-02053-0, në vendin e quajtur Gajrak-Rruga, me kulturë tokë pyjore mal i klasit 6, në pronësi të KK-Malishevës.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Malishevës,

Kuvendi i Komunës së Malishevës ka marrë vendimin nr.02/144, dt.23.05.2025, me të cilin ka iniciuar procedurën administrative për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër deri në pesëmbëdhjetë ( 15 ) vjet të pronës publike, sipërfaqen prej 6 /ha për qëllime të ndara, në pjesën e njësisë kadastrale P-72316001-02053-0, në vendin e quajtur Gajrak-Rruga, me kulturë tokë pyjore mal i klasit 6, në pronësi të KK-Malishevës, sipërfaqja e planifikuar për të u ndarë ka qen 6/ha, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 16.61.18/ha.

Pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga autoriteti mbikëqyrës MAPL-, është konstatuar që ky vendim nuk ka qenë në harmoni me ligjin, sipas shkresës së MAPL-së, nr.020/336/19, dt.04.07.2025, ku ndër të tjera Ministria konkludon se" *fillimisht duhet të bëhet ndarja fizike në kadastër e parcelës në dy pjesë ashtu siç është paraparë të jepet në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vite përmes procedurës së ankandit publik, e pastaj të procedohen vendime të veçanta për secilën sipërfaqe veç e veç*".

në ... / ... për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vite. Bajge 2025

ZYRA E PRANIMIT - IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal / Ministarstvo Lokalne Samouprave Administracije / Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-326/40
Dt. 25.08.2025

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Ekrem Kastrati ,Kryetar i Komunës së Malishevës<br>Argjend Thaçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së<br>Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së | |
| Nga: | Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor | Datë:<br>18.08.2025<br>Nr. 020-326/25 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendit Komunal dhe Kryetarit të Komunës<br><br>Gafurr Sllamniku, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin Administrative të Akteve të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Malishevës | |
| Lloji i aktit: | Vendim i kuvendit të komunës së Malishevës | |

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim Nr. 02/236 për shfuqizimin e Vendimit Nr. 02/144 të datës 23.05.2025 për inicimin e procedurës administrative për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vite përmes procedurës së ankandit publik |
| I miratuar më datë: 06.08.2025 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 15.08.2025 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, Ndërsa sa i përket përmbajtjes se aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se:

Akti i komunës në aspektin procedural <u>nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në</u>

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë 15.05.2025, ka miratuar Vendimin Nr. 02/144 për inicimin e procedurës administrative për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vite përmes procedurës së ankandit publik.

MAPL, konstaton se vendimi Nr. 02/144 për inicimin e procedurës administrative për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vite përmes procedurës së ankandit publik i nxjerrë nga kuvendi i komunës së Malishevës, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, poashtu është në kundërshtim me nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 2.1 i vendimit në fjalë përcakton se nga pjesa e njësisë kadastrale nr. P -72316001-02053-0 sipërfaqja e përgjithshme prej 166118 m2 pronë publike në emër të komunës së Malishevës jepet në shfrytëzim afatshkurtër deri 15 vjetë, sipërfaqja prej 2000m2 (2/h) përmes procedurës së ankandit publik.

MAPL, konstaton që sipas dispozitave ligjore të lartshënuara nuk lejohet që kryetari i komunës të propozoj e po ashtu as kuvendi i komunës të miratoj vendim përmes së cilit sipërfaqja e përgjithshme e parcelës që propozohet për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër është 6/h, ndërsa 2/h ndahen për deponi të materialeve inerte.

Në këtë rast parcela nr. P -72316001-02053-0, e cila përbehet prej sipërfaqes së përgjithshme 166118m2, fillimisht duhet të behet ndarja fizike në kadastër e parcelës në dy pjesë ashtu siç është paraparë të jepet në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vite përmes procedurës së ankandit publik, e pastaj të propozohen vendime të veçanta për secilën sipërfaqe veç e veç.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, kuvendi i komunës së Malishevës, duhet që të ndërmerr veprime të rishqyrtojë aktin dhe harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi Komunal Malishevë

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (i) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/04, qershor 2008, bazuar në nenin 53 paragrafi 3, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21, qershor 2016", nenit 13 paragrafi 13.7, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë:14.09.2023,

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e tretë (III) të rregullt të mbajtur me datë: 06.08.2025 merr këtë:

## VENDIM

1. Shfuqizohet vendimi nr.02/144 të datës: 23.03.2025, për iniciimin e procedurës administrative për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vite përmes procedurës së ankandit publik.

2. Shfuqizimi i vendimit me numër të cekur si më lartë bëhet në pajtim me shkresën e MAPL-së nr.020-326/19 datë: 07.07.2025.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes organeve kompetente.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr.03/040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi

Vendimi ju dërgohet :
MAPL-së
Arkivit të Komunës

23.05.2025
02/144

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/___
Datë:15.05.2025

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në bazë të nenit 11,12 Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 4 neni 5 par.5.1 shkronja ( b,d ) neni 12,14 par.1 neni 17, neni 40, Ligjit, nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 4, 5 par. I pika 1.1, neni 6 par. 6.1 pika 1.1, neni 8 par 1.1, neni 14 par.14.1, Rregullores (QRK)Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale neni 4, neni 5 par. 1 pika 1.2, neni 12 , Ligjin nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 4, 32, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 49 par.1 pika 1.3, neni 83, Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.02/484, dt.10.01.2024, miratim paraprak të listës së pronave të paluajtshme të komunës e planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025, i konfirmuar sipas Konfirmimit të MAPL-së, nr.020/27/11 dt.22.01.2025,

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhje e mbajtur me datë, 15.05.2025, mori këtë;

# VENDIM

*PËR INICIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIE PËR DHËNINË NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS PUBLIKE DERI NË 15 VITE PËRMES PROCEDURËS SË ANKANDIT PUBLIK*

1.Kuvendi i Komunës së Malishevës miraton, kërkesën e kryetarit të komunës së nr.01/574, dt.13.05.2025, për inicimin e procedurës administrative për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të lokacionit të përcaktuar për deponi publike për materiale inerte të shkaktuara nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore, në territorin e Komunës së Malishevës, të përcaktuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, Vendimi nr.02/219, dt.05.05.2022.

2. Dhënia në shfrytëzim të lokacionit të përcaktuar për deponi të materialeve inerte, të shkaktuara nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore në territorin e komunës së Malishevës, i përcaktuar sipas vendimit të lartcekur, do të jepet në shfrytëzim sipas procedurës së ankandit publik, parapare me ligjin në fuqi, cekur si më lartë.

2.1 Bazuar në vendimin nr.02/219, dt.05.05.2022, lokacioni është përcaktuar në pjesën e njësisë kadastrale nr.P-72316001-02053-0, ZK-Banjë, në vendin e quajtur" Gajrak –Breg" tokë pyjore e klasit 6, në sipërfaqe të përgjithshme prej 166118 m $^2$, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, *nga kjo njësi kadastrale jepet në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vjetë,* sipërfaqja prej 2000 m$^2$ ( 2/h) përmes procedurës së ankandit publik.
2.2 Afati i dhënies në shfrytëzim është 15 ( pesëmbëdhjetë ) vite.
2.3 Çmimi fillestar në procedurë ankandi për një hektarë është 500.00 €, ndërsa për sipërfaqen e përgjithshme prej 2000 m $^2$ do të jetë 1,000.00 €
2.4 Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale të cekur si më lartë është interesi ekonomik, funksionalizimi i deponisë për hedhjen e materialeve inerte të shkaktuara nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore, në territorin e Komunës së Malishevës, të përcaktuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, krijimin e mundësive për zhvillim ekonomik, duke krijuar të hyra afatgjate për buxhetin e KK-së, në Malishevë ndërsa pas përzgjedhjes së operatorit më të favorshëm

ekonomik, për menagjimin e lokacionit për deponi, do të zbatohen procedurat ligjore që e rregullojnë këtë çështje.

3. Procedura e dhënies në shfrytëzim të pronave të cekur si më lartë, zhvillohet përmes ankandit publik konform Ligjit, nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale.

4. Pronat e paluajtshme në fjalë nuk e ndërrojnë titullarin juridik, pronësia i mbetet Kuvendi Komunal të Malishevës, dhe si të tilla ato nuk mund tu jepen personave të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, , nuk mund të tjetërsohen, nuk mund të jenë objekt i ndonjë barre tatimore, bankare apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këto prona pa pëlqimin e pronarit.

5. Ky vendim është paraprak, dhe pas përfundimit të procedurave të ankandit publik, rekomandimit të komisionit vlerësues, do të nënshkruhet kontrata në mes të palës fituese dhe kryetarit të komunës.

6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kërkesa e kryetarit të komunës,nr.01/574, dt.13.05.2025, skica grafike dhe certifikata e njësisë kadastrale, Vendimi i Kuvendit nr.02/219, dt.05.05.2022, Vendimi nr.02/484, dt.10.01.2025, për miratimin paraprak të listës së pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025.

7. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i komunës, përmes drejtorisë për gjeodezi, kadastër.

8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe 7 ( shtat ) ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet;
1.MAPL-së ,
2.Zyrës së Kryetarit,
3.Arkivit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Arbnor Gashi

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72316001-02053-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **549/26** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 17.03.2026 - 13:24 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Banjë / Banja / Bajë |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-72316001-02053-0** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | **166118** | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| GAJRAK-RRUGA | 0 | | | |

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pyjor/šumsko/Forestry | Tokat Pyjore/šumsko zemljište/Forest | Mal I Klasës 6/Suma 6 Klase/6th Class Forest | **166118** |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>Single possessor | **Komuna e Malishevës** | 600535259 | / / / | | | **1/1** | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : MALISHEVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Banjë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-72316001-02053-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 166118 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:5271

Punoi/Obradio/Created: Armend Krasniqi

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 18.03.2026

Koha/ Vreme/ Time: 09:48:21

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

***Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning***

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72316001-02053-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **549/26** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 17.03.2026 - 13:24 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Banjë / Banja / Bajë |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-72316001-02053-0** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | **166118** | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| GAJRAK-RRUGA | 0 | | | |

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pyjor/šumsko/Forestry | Tokat Pyjore/šumsko zemljište/Forest | Mal I Klasës 6/Suma 6 Klase/6th Class Forest | **166118** |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Malishevës** | 600535259 | / / / | | | **1/1** | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : MALISHEVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Banjë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-72316001-02053-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 166118 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:5271

Punoi/Obradio/Created: Armend Krasniqi
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 18.03.2026
Koha/ Vreme/ Time: 09:48:21